



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:290155
Datë: 19.11.2024
Numri i dokumentit: 06473247

AC.nr.3558/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët: Mevlide Kosumi - Qarri kryetare e kolegjit, Nehat Idrizi dhe Hunaida Pasuli anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.(L.) M. nga Fshati B.- Komuna O., që sipas autorizimit e përfaqëson avokat S. K. nga Shoqëria e Avokatëve Klinaku & Associates me seli të zyrës në Prishtinë, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A. (KEK), me seli në Prishtinë, Sheshi “Nënë Tereza” nr. 36, të cilën me autorizim e përfaqëson F. Sh. - Zyrtare Ligjore në KEK, për pagesën e tre pagave jubilarë, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të autorizuar të së paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.4466/2019, të datës 26.04.2021, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 18.11.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës SH.A. me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.4466/2019, të datës 26.04.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e atakuar ka vendosur si vijon: “I. Aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit F.l (L.) M. nga Fshati B. - Komuna O., si e bazuar.II. Detyrohet e paditura Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A. me seli në Prishtinë që paditësit t’ia paguaj në emër të tri pagave jubilarë shumën 2,436.00 €, me kamatëvonesë 8%, e cila do të llogaritet nga data e marrjes së këtij aktgjykimi 26.04.2021, e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga data e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm. III. Obligohet e paditura që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 270.00 €, në afat prej 7 ditësh nga data e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm”.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së, vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe

aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën si të bazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar të ndryshohet me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, përmes përgjigjes në ankesë, ka propozuar që ankesën e të paditurës ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta vërtetoj.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi me padinë e parashtruar ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit dhe të detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj tri paga në emër të shpërblimeve jubilarë në shumë prej 2,436.00 €, me kamatë prej 8% e cila do të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar në rastin konkret e paditura si punëdhënës i fundit ka pasur për detyrim që paditësit t'ia paguaj 3 paga në emër të shpërblimit jubilar për 40 vite të përvojës së punës të cilat i ka përmbushur në Janar 2019. Kjo për faktin se ky detyrim është paraparë me nenin 52 paragrafi 1 pika 3 të MPKK-së e cila ka vazhduar të zbatohet për punëtorët e të paditurës në bazë të vendimit me nr.2.... të datës 10.04.2019 dhe vendimit me nr. 8... të datës 23.08.2019. Paditësi duke u bazuar në kartelën e punëtorit të lëshuar me datë 11.11.2019 konstatoi se i njëjti ka arritur vitin jubilar prej gjithsej 40 vite përvojë pune të pandërprerë në fillim të muajit Janar 2019, pra ka mbushur vitet e nevojshme të përvojës së punë për shpërblim jubilar sipas paragrafit III të vendimit të të paditurës me nr.8....Gjykata vendimin e mbështet edhe në ligjin e punës konkretisht në nenin 87 ku afati i parashkrimit të kërkesave nga marrëdhënia e punës është 3 vite. Pra në rastin konkret kërkesëpadia në gjykatë është paraqitur në datë 13.12.2019, ndërsa paditësi e ka përmbushur kushtin për shpërblim jubilar në fillim të vitit 2019, andaj gjykata vlerësoi se këtu nuk kemi të bëjmë me parashkrimin e kërkesës së paditësit për shpërblimin jubilar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në

mënyrë të drejtë, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë pretenduar nga pala ankuese.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1, pika n) të LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Si rrjedhojë gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe faktet vendimtare si marrëdhënia e punës dhe përvoja e punës së paditësit tek e paditura.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale për arsye se me neni 90 paragrafi 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 të datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) në nivel të vendit, b) nivel të degës, dhe c) në nivel të ndërmarrjes”*. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhët zyrtare të Republikës”*. Me paragrafin 4 përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”*. Ndërsa me nenin 52 paragrafi 1 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të datës 18.03.2014, përcaktohet se: *“I punësuar ka të drejtë në shpërblimin jubilarë” dhe atë: a) për 10 vite të përvojës së punës së pandërprerë, te punëdhënësi i fundit , në vlerë të një page mujore të tij, b) për 20 vite të përvojës së punës së pandërprerë, te punëdhënësi i fundit , në vlerë të dy paga mujore të tij, dhe c) për 30 vite të përvojës së punës së pandërprerë, te punëdhënësi i fundit , në vlerë të tri paga mujore të tij”*. Me paragrafin 2 të kësaj Marrëveshje përcaktohet se: *“Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë”*, ndërsa në paragrafin 3 përcaktohet se: *“Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”*.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës së paditur se kërkesa e paditësit është e parashkruar, pasi që paditësi padinë e ka dorëzuar në gjykatë me datë 13.12.2019 ndërsa i njëjti kërkon të drejtën e cila buron nga MPKK-së e cila ka qenë e zbatueshme nga data 01.01.2015 deri me datë 31.12.2017, ndërkaq me dispozitat ligjore të Ligjit të Punës me të cilat parashihet parashkrimi me nenin 87 përcaktohet: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, ndërsa me nenin 341 par.2 të LMD-së parashihet: *“Parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit”*. Në rastin konkret padia është parashtrur brenda afatit prej dy vitesh nga zbatueshmëria e kësaj marrëveshje, pra nuk ka kaluar afati 3 vjeçar i përcaktuar me ligj. Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor se me vendimin e të paditurës nuk parashihet njohja e pagave jubilarë për mbi 10-20-30 vite të përvojës së punës dhe se paditësi gjatë kësaj periudhe kohore nuk ka arritur këtë kusht për të qenë përfitues i

shpërblimit jubilar, është pretendim i pa bazuar, ngase me Vendimin e të paditurës Nr.8201 të datës 23.08.2019 i cili është plotësuar i Vendimit nr.2244 të datës 10.04.2019 lidhur me pagat jubilarë në parag. 3 thuhet: *“Punëmarrësit të cilët kanë arritur përvojën e punës 40 vite e gëzojnë këtë të drejtë njëjtë sikurse punëtorët që kanë arritur përvojën e punës 30 vite”*. Ndërsa sa i përket përvojës së punës është e pa kontestueshme e kjo është vërtetuar edhe nga Vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 23.08.2028 për shkak se paditësi ka arrit moshën e pensionimit, ku paditësi ka pasur mbi 41 vjet përvojë pune, që do të thotë se në vitin 2017 ka arritur 40 vjet përvojë pune. Gjykata ankimore gjeti se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të drejtuar drejt aktgjykimit të Gjykatës së shkallës së parë, andaj, aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së parë kjo Gjykatë e vlerëson si të drejtë dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit e pranon si të drejtë qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, për sa i përket vendimit për shpenzimet e procedurës, pasi që të njëjtat janë gjykuar në përputhje me nenin 452.1 të LPK-së, ndërsa kamata ligjore është gjykuar në përputhje me nenin 382 të LMD-së.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195 paragrafi 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, Gjykata e Apelit ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

AC.nr.3558/2022, datë 18.11.2024

Kryetarja e Kolegjit
Mevlode Kosumi Qarri d.v